# STATUTI

## "Shoqata e bashkatdhetarëve rus në Republikën e Shqipërisë"

### Neni 1

Shoqata e bashkëatdhetarëve rus në Republikën e Shqipërisë, formohet nëpërmjet dëshirës së mirë së bashkimit me qëllimin e thellimit të lidhjeve ndërmjet qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe atyre të Federatës Ruse, gjithashtu realizimin e të drejtave të banorëve të Rëpublikës së Shqipërisë pamvarësisht nga orientimi i tyre politik ose besimi i tyre fetar.

### Neni 2

Shoqata e bashkëatdhetarëve rus në Republikën e Shqipësrisë për realizmin e qëllimeve të saja, do të veproje në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, legjislacionit shqiptar si dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore. Aktiviteti i Shoqatës do të jetë i një karakteri të hapur për të tërë.

### Neni 3

Emërtimi zyrtar i Shoqatës është SHOQATA E BASHKËATDHETARËVE RUS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.

### Neni 4

Selia e shoqates eshte ne adresen :
Rruga Beqir Luga Pallati 24 Tirane.

### NENI 5

Shoqata është juridikisht e ligjëruar dhe ka vulën e saj, stampën, faturën e llogarisë, emblemën, flamurin dhe simbloe të tjera.

Vula ka formë rrethore dhe përmban emërtimin e Shoqëatës: Shoqata e bashkëatdhetarëve rus në Republikën e Shqipësrisë.

Stampa ka formë drejtkëndore dhe përmban tekstin: Shoqata e bashkëatdhetarëve rus në Republikën e Shqipësrisë, numrin, datën, vendin.

Emblema dhe flamuri konfirmojnë Formimin e Shoqatës.

## Qëllimet dhe detyrat e shoqatës

### Neni 6

Qytetarët hyjnë në antarësinë e Shoqatës për realizimin e qëllimeve, të drejtave dhe detyrimeve të mëposhtme:

- Shprehja, ruajtja dhe zhvillimi i traditave të bashkëatdhetarëve rus, të cilët jetojnë në Republikën e Shqipërisë.
- Suportimi dhe zhvillimi i potencialit shpirtëror dhe intelektual të tyre, gjithashtu si gjuhësor ashtu edhe kulturor.
- Vendosja e lidhjeve të gjithëanshme me bashkëatdhetarët rus që jetojnë në republikat e Federates Ruse, dhe shtetet e tjera.
- Realizimi i të drejtave civile dhe i intersave të bashkëatdhetarëve rust ë cilët jetojnë në Republikën e Shqipërisë.
- Mledhja e lehtësirave dhe dhënia e ndihmës humanitare anëtarëve të pambrojtur të Shoqatës dhe qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.
- Dhënia e ndihmave anëtarëve të Shoqatës në lidhje me të drejtat e trashëgimisë në lidhje me pasuritë në Federatën Ruse në përputhje me ligjet ruse dhe ato të vendit aktual.

### Neni 7

Në sferën e realizimit të qëllimeve, aktiviteti i Shoqatës bazohet në dy ide të rëndësishme: ndërtimi i komisioneve dhe i grupeve të punës, dhe realizimi i projekteve.

Ideja e komisionit dhe i grupeve të punës shikon bashkimin dhe aktivitetin e përbashkët të antarëve të Shoqatës sipas grupeve të interesit.

Ideja e projekteve shikon që aktiviteti i gupeve të interesit duhet të jetë e drejtuar në realizimin e projketeve konkretë.

## Antarësia në Shoqatë

### Neni 8

Antarësia në Shoqatë është idividuale. Çdo anëtar i shoqates mund te marrë pjesë në organet drejtuese ose ne personelin administrative te shoqates.

### Neni 9

Anëtar individual i Shoqatës mund të bëhet çdo qytetar mbi moshën 18 vjeç i Republikës së Shqipërisë, që është bashkatdhetar rus dhe që ruan dijet e gjuhës

ruse, trashëgiminë kulturore, traditat, zakonet dhe firmosjen e kërkesës për hyrjen në Shoqatë.

NOTER TIRANE

### Neni 10

Anëtar nderi mund të jetë qytetari i Republikës së Shqipërisë ose i një organizatë joqeveritare tjetër me kombësi ruse, ose me kombësi tjetër, të cilët respektojnë kulturën, traditat, zakonet ruse, suportojnë aktivitetin e shoqatës dhe kanë një kontribut në punën e seksesshme të saj.

### Neni 11

Shoqata i jep antarëve të saj librat e antarësisë, në të cilët shënohet data e pagesës së detyrimeve.

Të drejtat dhe detyrimet e anëtarit hyjnë në fuqi në momentin e pagesës së detyrimit dhe dalin jashtë fuqie mbas skadimit të një viti kalendarik.

## Të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të Shoqatës

### Neni 12

Anëtari i Shoqatës ka të drejtën e zgjedhjes dhe e të zgjedhurit në organet e Shoqatës. Çdo anëtar mund të dali nga Shoqata vullnetarisht.

Mohimi i antarësimit mundet vetëm atëherë, kur anëtari i Shoqatës nuk i bindet rregullave në fuqi. Mohimi i antarësimit bëhet në bazë të një dokumenti të veçantë, i cili merret me rastet e antarësimit në Shoqatë.

### Neni 13

Secili anëtar i Shoqatës ka këto të drejta dhe detyrime:

- Të zbatojë rregulloren në fuqi;
- Të mbajë rregullin, disiplinën dhe atmosferën demokratike në aktivitetet e Shoqatës;
- Të marri pjesë në takimet dhe aktivitet e tjera të komisioneve dhe grupeve të punës, të drejtojë pyetje dhe të marrë për to përgjigjet, të marrë pjesë dhe të ketë të drejtën e zërit nëpër diskutime;
- Të marrë pjesë në seminaret edukativë;
- Të marrë libirn e antarësisë, dhe të paguajë rregullisht detyrimet ndaj Shoqatës;

**Neni 14**

Shoqata mban listën e antarësisë, e cila konsiston në listën e vet të saj, resgjistrin e antarëve të mbledhjes, regjistrit të grupeve të punës dhe regjistrit të prjekteve.

Rregulli i punës me listë vendoset sipas rregullores.

**Financimi i Shoqatës**

**Neni 15**

Financimi i Shoqatës bëhet në këto mënyra:

- Mbledhja e detyrimeve të antarësisë;
- Ndihma financiare dhe sponsorizimet;
- Shërbimet;
- Ngritja e fondeve me projekte konkrete.

**Neni 16**

Detyrimi i përvitshëm i antarësisë për antarët e shoqatës vendoset nga mbledhja e Përgjithshme e Shoqatës.

**Struktura organizative dhe organet drejtuese të Shoqatës**

**Neni 17**

Shoqata mund të kijojë degët e saja, në ato zona të populluara me të paktën dhjetë anëtarë individualë Shoqate.

Në rast banimi në më pak se dhjetë antarë individualë në një zonë, shihet mundësia e bashkimit të këtyre degëve me ato të zonave përreth.

**Neni 18**

Ogranet e Shoqatës janë:

1. Mbledhja e Përgjithshme e gjithë anëtarëve të shoqatës,asambleja.
2. Asambleja e shoqates mund te zgjedhe organet e tjera drejtuese te shoqates.

**Neni 19**

Organi më i lartë i shoqatës është mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të saj, asambleja.

Organet e tjera drejtuese te shoqates. qe mund te zgjidhen nga asambleja, përgjigjen dhe japin llogari përpara këtij organi.

**Neni 20**

Detyrimet e Shoqatës:

1. Të miratoje statutin, programin e përvitshëm, planin financiar;
2. Të pranojë:
   - Rregulloren e aktiviteteve të Shoqatës,
   - Raportin e përvitshëm dhe periodik për aktivitetet e Shoqatës,
   - Raportin finanicar, për gjëndjen financiare të Shoqatës,
   - ga antarësia;
3. Të marrë vendim për:
   - Krijimin e organeve drejtuese te shoqates
   - Numrin e antarëve në organeve drejtuese te shoqates qe mund te zgjidhen nga asambleja.
   - Ndryshimet në rregullore dhe dokumente të tjera të Shoqatës,
   - Ngritjen dhe shpërbërjen e degëve të Shoqatës.
   - Vendosjen dhe prishjen e lidhjeve me organizatat e tjera dhe për antarësimin në e bashkësive dhe organizatave ndërkombëtare.

**Neni 21**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqates eshte e pa kufizuar.

**Shpërbërja e Shoqatës**

**Neni 22**

Shoqata shpërbëhet në rastet kur:

- Ky vendim merret me 2/3 e votave të Mbledhjes se Pergjithshme te antereve te saj.
- Numri i antarëve bëhet më i vogël se norma e lejuar ne ligj.

Në rast se realizohen një nga shkaqet e mësipërme, përfaqësuesi i Shoqatës është i detyruar që gjatë 15 ditëve të infomojë me shkrim gjykatën në Tiranë, në mënyrë që të heqi Shoqatën nga lista e Shoqatave dhe fondeve.

**Neni 23**

Ndryshimet dhe shtesat në statut mund të behen sipas procedurës analoge të miratimit të saj.

**Nenii 24**

Statuti hyn në fuqi në datën e miratimit të saj.

**ANËTARET THEMELUES**

**SUZANA KARAGJOZI** **LUAN PENGILI** **ARJANA RISILIA**

**ALMIRO GURAKUQI** **MAKSIM VESHI**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**Nr.** 656 **Rep.**

**V E R T E T I M**

Sot ne date 01 .02.2007 u parqiten para meje noteres anetaret themelues te shoqates;
**Suzana Karagjozi,** shtetase shqiptare, e datelindjes 07.05.1957, me zotesi juridike per te vepruar, me nr. pasaporte nderkombetare Z 1986715.
**Arjana Risilia,** shtetase shqiptare, e datelindjes 24.01.1959, me zotesi juridike per te vepruar, e pajisur me certifikaten nr 28/40 leshuar nga zyra gjendjes civile Tirane.
**Luan Pengili,** shtetase shqiptar, e datelindjes 28.03.1957, me zotesi juridike per te vepruar, me nr. pasaporte nderkombetare Z 1001760.
**Maksim Veshi,** shtetas shqiptar i datelindjes 23.06.1960, banues ne Tirane , madhore me zotesi juridike per te vepruar, me nr. pasaporte z 0538759.
**Almiro Gurakuqi,** shtetas shqiptar i datelindjes 27.12.1972, banues ne Tiranre, madhor, me zotesi juridike per te vepruar, me nr. pasaporte z 0186658.
Per identitetin e te cilave u sigurova nga pasaportat e paraqitura nga ana e tyre, te cilet deklaruan se me vullnetin e tyre te lire kane nenshkruar statutin per krijimin e shoqates "Shoqata e bashkeatdhetareve rus ne Republiken e Shqiperise ". Ne keto kushte une noterja e vertetoj sipas ligjit.

PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE

**NOTERE**

Ilir Qepani